



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 94/2 prot.,

Datë 20.01.2023

**FORMULAR PËR PUBLIKIM**  
**LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR**  
**VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR**

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PERSON FIZIK në procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar me mjete elektronike”, me Nr. REF-54973-12-23-2022, me objekt: “Blerje Uniforma për Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë e Shërbimit të MZSH-së, Bashkia Fier, me 2 lote”, me fond limit 3.936.677 lekë pa TVSH, Loti II me Nr. REF-54980-12-23-2022, me objekt: “Blerje Uniforma për Drejtorinë e Shërbimit të MZSH-së”, me fond limit të lotit 1.567.433 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 09.01.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

**Ankimues:** “Gentian Sadiku” PERSON FIZIK  
Adresa: Rruga “Tom Plezha”, Pallati Milo, Nr. 7, Zona kadastrale 3866, Pasuria 298/211-N11, Yzberisht, Kashar, Tiranë.

**Autoriteti Kontraktor:** Bashkia Fier  
Adresa: Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15, Fier.

Në datën 19.01.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është protokolluar ankesa me nr. 93 prot., e operatorit ekonomik “Gentian Sadiku” PERSON FIZIK për procedurën e prokurimit “E hapur e thjeshtuar me mjete elektronike”, me Nr. REF-54973-12-23-2022, me objekt: “Blerje Uniforma për Policinë Bashkiake dhe Drejtorinë e Shërbimit të MZSH-së, Bashkia Fier, me 2 lote”, me fond limit 3.936.677 lekë pa TVSH, Loti II me Nr. REF-54980-12-23-2022, me objekt: “Blerje Uniforma për Drejtorinë e Shërbimit të MZSH-së”, me fond limit të lotit 1.567.433 lekë pa TVSH zhvilluar më datë 09.01.2023, nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PERSON FIZIK.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:  
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Gentian Sadiku” PERSON FIZIK kundërshton me anë të ankesës me nr. 94 prot., datë 19.01.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

### **Arsyet e skualifikimit:**

*“Operatori ekonomik “GENTIAN SADIKU” PF me NUIS L42314005A*

*Bazuar në Kriteret e Përgjithshme të kualifikimit sipas Shtojcës 7 të DST, si dhe kritereve të veçanta të kualifikimit:*

*2.3 Kapaciteti teknik:*

*2.3.6 Operatorët Ekonomikë pjesëmarrës duhet të paraqesin mostrat (kampionet), për artikullin si më poshtë, në ditën e hapjes së ofertave, në orën dhe vendin e caktuar në dokumentat e tenderit: NIVELI I MESËM (ADMINISTRATA):*

*Kostum (xhaketë, pantallona, kapele)*

*Mostra e kërkuar duhet të kenë një etiketë të ngjitur, e cila do të përmbajë:*

*mostër “emri i artikullit”, numrin rendor sipas ofertës së paraqitur, objektin dhe datën e zhvillimit të tenderit, emrin e ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik ofertues.*

*Mostra duhet të jenë në përputhje me të gjitha specifikimet teknike të kërkuara.*

*Mostra do të dorëzohet përpara komisionit, në orën dhe datën e përcaktuar për hapjen e ofertave, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Fier , Drejtoria e KVO, Kati i IV-të, Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Fier.*

*Nga Operatoir ekonomik u paraqit mostra Kostum (xhaketë, pantallona), por nuk u paraqit mostra për zërin “kapele” duke mospërmbushur zërat në tërësi të mostrës kostumi të kërkuar sipas DST-së xhakete, pantallona, kapele, çka përbën shkak për skualifikim”.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 20.01.2023.

## **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Anila Malaj**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

